



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Data \_\_\_/\_\_\_/2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Uniforma dhe aksesore per Policine Bashkiake dhe MZSH-ne”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 35811100-3;  
35811200-4.

VLERA E FONDIT LIMIT: **2,280,300** (dy milion e dyqind e tetedhjetë mijë e treqind) Lek pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Lezhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar dhe kërkohej një operator ekonomik i cili të ketë minimumin e kërkuar duke marrë në konsideratë objektin e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

**2.2.2** Një dokument që vërteton se subjekti ka plotësuar të gjitha detyrimet të maturuara të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument.

*Shenim: Kjo kërkesë permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenin 43, nenin 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 "Per QKB" i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 "Per QKR" i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

---

a-Kur furnizimet e ngjashmë janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

*ose*

b-Kur furnizimet e ngjashmë janë realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur faturat tatimore të shitjes ku shënohen mallrat, shumat dhe vlerat.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/ distributorin e autorizuar për mallrat sipas tabelës së mëposhtme:

1. b) Uniforma e personelit operues (zjarrfikës) të MZSH	
Nr	Emërtimi
1	Xhup
Kostum pune dimri	
A	Xhaketë
B	Pantollona
2	Këpucë dimrore

2. Uniforma për policinë Bashkiake	
Nr	Emërtimi
1	Xhup blu i erret
2	Kostum pune dimri
3	Këpucë dimrore

Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar, për materialet e sipërcituara.

**2.3.3** Dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (raporte testimi) të materialeve përbërëse të produkteve, të lëshuara nga laboratorë të akredituar sipas standardeve kombëtare/ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike, të materialeve përbërëse të produkteve të mëposhtme:

1. b) Uniforma e personelit operues (zjarrfikës) të MZSH	
Nr	Emërtimi
1	Xhup
Kostum pune dimri	
a	Xhaketë
b	Pantollona
2	Këpucë dimrore

2. Uniforma për policinë Bashkiake	
Nr	Emërtimi
1	Xhup blu I erret
2	Kostum pune dimri
3	Këpucë dimrore

**Argumentimi 2.3.2;2.33;** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

8. *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”*

Sa me sipër shfaqet e nevojshme që për mallrat objekt prokurimi, të paraqiten Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar dhe raport analiza, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produktit me specifikimet teknike.

Ne lidhje me këto kritere NJ.P. gjykon se janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me artikullin e kërkuar.

Akoma më tej NJ.P. gjykon se dokumentat e kërkuar Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar, raport testimet mund të sigurohen lehtësisht nga operatorët ekonomikë të cilët kanë për objekt të veprimtarisë së tyre furnizimin me këto kategori produktesh për të cilat kanë për detyrë të dëshmojnë në çdo rast origjinalitetin e tyre dhe të dhenat teknike për këto produkte. Po ashtu me këto kritere të vendosur, autoriteti kontraktor nuk ka tejkalar objektin e prokurimit pasi për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet “mall”, sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera këto pajisje:

- ❖ 1 (një) makineri qëndisje;
- ❖ 1 (një) linjë stampimi me serigrafë (makineri stampimi, furrë tharje stampimi dhe presë për ngjitjen e logove)

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vertetojnë pronësinë e tyre ose marrjen me qira të tyre: (faturë tatimore të shitblerje/aktet e zhdoganimit, origjinale ose fotokopje të noterizuar, ose cdo lloj akti tjetër ligjor që vërteton pronësinë ose kontratë qiraje). Për makineritë me qira duhet të paraqitet kontrata e qirasë, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë e qiradhënësit (fatura tatimore ose zhdoganimi ose cdo lloj tjetër ligjor që vërteton pronësinë e qiradhënësit).

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.*

**Argumentimi:2.3.4** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi/qera ose kontrate bashkepunimi janë vlerësuar si të nevojshme dhe në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar mallrave sipas preventivit dhe specifikimeve teknike. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

**2.3.5** Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatë OEKO-TEX “ose ekuivalente”, (të lëshuar në emër të tij ose të prodhuesit, si dhe të vertetohet lidhja me prodhuesin ne qofte se eshte ne emer te prodhuesit) per lenden e pare te uniformave. Në rastin kur lëndët e para sigurohen nga prodhues të ndryshëm, çertifikata ose dokumenti ekuivalent me të, duhet të paraqitet për të gjithë prodhuesit.

**2.3.6** Operatorët Ekonomike ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, konkretisht:

- **ISO 9001:2015**, mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalentin e saj
  - **ISO 45001:2018**, mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë”, ose ekuivalentin e saj
-

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

**Argumentimi:2.3.5, 2.3.6** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Referuar natyrës se veçantë, të objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë mjedisit dhe shëndetit. Sistemi i menaxhimit të cilësisë dhe shëndetit janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të të gjithë artikujve të kërkuar në adresën e autoritetit kontraktor sipas kërkesave të ketij te fundit.

**Argumentimi 2.3.7:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike”, për artikujt sipas tabelës së mëposhtme:

1. b) Uniforma e personelit operues (zjarrfikës) të MZSH	
Nr	Emërtimi
1	Xhup
Kostum pune dimri	
a	Xhaketë
b	Pantollona
2	Këpucë dimrore

2. Uniforma për policinë Bashkiake	
Nr	Emërtimi
1	Xhup dimri
2	Kostum pune dimri
3	Këpucë dimrore

Në plotësim të kësaj kërkesë dokumenti “Ofertë Teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i produkteve	Emërtimi kompanisë prodhuese.	Emërtimi i katalogut ose skedës teknike	Shënime (nëse gjykohet e nevojshme për sqarime nga ofertuesi)
-----	-----------------------	-------------------------------	---	---

--	--	--	--	--

**Argumentimi: 2.3.8;** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

**2.3.9** Ditën dhe orën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Nga 1 (nje) mostër për secilin nga artikujt e mëposhtëm:

1. b) Uniforma e personelit operues (zjarrfikës) të MZSH	
Nr	Emërtimi
1	Xhup
Kostum pune dimri	
a	Xhaketë
b	Pantollona
2	Këpucë dimrore

2. Uniforma për policinë Bashkiake	
Nr	Emërtimi
1	Xhup dimri
2	Kostum pune dimri
3	Këpucë dimrore

- Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë magazines së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, së Bashkisë Lezhe me adresë: Rruga “Vellezerit Coku”, Ish SMT, Lezhe.
- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.
- Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.

**Argumentimi 2.3.9:** Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit”

Autoriteti Kontraktor ka perzgjedhur qe te paraqiten mostrat per nje liste mallrash qe jane te lidhur ngushtesisht me perdorimin nga punonjesit ku te cilat mund te shkaktojne demtime ne shendetin e punonjesve apo perdoruesve te ketyre mallrave. Per rrjedhoje duke qene se keto mallra ndikojne drejtpersdrejti ne shendetin e punonjesve eshte kerkuar qe per keto mallra te paraqiten mostra me qellim krahasimin me specifikimet teknike.

**Sqarim:** Ne cdo rast qe mund te permendet ne preventiv emer marke/prodhuesi ose "Importi", "Cilësi e I-rë", do te pranohet edhe ekuivalenti i tij.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

#### **ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:**

Njesia pergjegjese citon se ka hartuar specifikimet teknike, ku jane shprehur qarte kerkesat AK per realizimin e kontrates.

Njesia pergjegjese ne specifikimet teknike argumenton se nuk ka permendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.